



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Kosovës
Komisioni për Integritime Evropiane
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, më 07. 07. 2008
Ndërtesa e Kuvendit, ora 11:00, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje ishin të pranishëm: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Džezair Murati, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri, Sabri Hamiti, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani, dhe Naser Rugova, kurse mungoi Branislav Grbić.

Të ftuar:
Ministri i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor- Mahir Yagcilar.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani, Ahtere Loxha, Adelina Demolli dhe Manush Krasniqi.

Blerim Vela -OSBE, Marie Berishaj -OSBE, Hazbije Krasniqi -MMPH, Federica Domanin -ECLO, Nexhat Shatri -Zyra e Presidentit, Friederike Wünschmann -ECLO, Floreta Kabashi -AIE/ZKM dhe Sabiha Shala - AIE/ZKM.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi, kryetare e Komisionit me këtë

R E N D I T E

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 3. Dëgjim me ministrin e Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me strategjinë e kësaj ministrie për përmbushjen e kritereve për integritime evropiane,**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

3. Dëgjim me ministrin e Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me strategjinë e kësaj ministrie për përmbushjen e kritereve për integritet evropiane

Zylfije Hundozi - Falënderoi për gatishmërinë e ministrit për t'i paraqitur të arriturat e Ministrisë dhe e ftoi atë ta paraqiste strategjinë për përmbushjen e kritereve për integritet evropiane.

Mahir Yagcilar - Tha se prioritete për ministrinë tonë janë mbrojtja dhe planifikimi hapësinor. Shtoi se ekzistojnë probleme serioze në lidhje me sasinë dhe kualitetin e ujërave, me menaxhimin e mbeturinave dhe me ndotjen e ajrit. Sa i përket gjendjes mjedisore ka probleme të shumta të akumuluar me dekada dhe si pasojë e shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore dhe të minierave. Sfidë e Qeverisë janë vendosja e kuadrit ligjor mjedisor dhe zbatimi i tij në mënyrë që të parandalohet degradimi i mëtutjeshëm i mjedisit. Sa i përket Planit të Kosovës për veprim në mjedis tha se është duke vazhduar zbatimin sipas projekteve, për të cilat edhe është ndarë vija buxhetore. Ai njoftoi se është formuar grupi i ekspertëve për projektin e krijimit të sistemit monitorues të ajrit. Shtoi se me përkrahjen e Qeverisë holandeze është duke u zbatuar projekti për vlerësimin mjedisor dhe për Planin e veprimit për rehabilitimin e minierave të Trepçës në Stantërg dhe në Artanë. Sa u përket hapave të ardhshëm tha se do të vazhdojmë me hartimin dhe përafrimin e legjislacionit mjedisor me atë të Bashkimit Evropian, si dhe me përmbushjen e veprimeve që dalin nga Plani i veprimit për vitin 2008 me kapacitetet ekzistuese njerëzore dhe me ndihmën e TAIXE-it aty ku konsiderohet e nevojshme.

Nait Hasani - Tha se ndër më të rëndësishmet i konsideroj mbrojtjen nga ndotja e ambientit dhe mbrojtjen e ajrit nga ndotja. Pyeti: Çka ka ndërmarrë Ministria që të mos lejohet të tejkalohet limiti i dyoksidit të karbonit në ajër, në mënyrë që të parandalohet shndërrimi i Prishtinës në zonë industriale.

Dzezair Murati - Tha se gjatë udhëtimeve që i kanë pasur në shtetet e Perëndimit kanë parë se si funksionon dhe si është rregulluar çështja e liritetit të dyoksidit të karbonit. Shtoi e dimë se në vendet e zhvilluara ka një kontroll shumë të madh të ushqimit, si dhe të materieve që hidhen si mbeturina. Një gjë e tillë te ne nuk ekziston. Propozoi të merremi më shumë me problemet e përditshme të shoqërisë, në mënyrë që edhe ne t'i tejkalojmë këto vështirësi.

Naser Rugova - përkrahu nismën për hartimin e disa ligjeve si dhe nismën e kësaj ministrie për hartimin e strategjisë së mbrojtjes së ambientit. Propozoi të respektohet legjislacioni në fuqi. Lidhur me mbrojtjen e lumenjve tha se janë bërë disa hapa pozitivë, por propozoi të parashtrohen projekte konkrete, sepse për mbrojtjen e lumenjve Evropa ka donacione të mëdha.

Sabri Hamiti - Pyeti se cili është programi konkret për Konferencën e Donatorëve për fushat që po bisedohet. Shtoi se sa pyeteni në rastet kur ka ndërtime të gjigantëve dhe sa dini ju për gjendjen e mundshme të ambientit pas ndërtimit të prodhuesve të rinj.

Bujar Bukoshi - Propozoi të ndërmerren tani hapa konkretë për mbrojtjen e pyjeve dhe për parandalimin e djegies së tyre para se të bëhet shumë vonë.

Edita Tahiri - Tha se në një anë e kemi Termocentralin Kosova C dhe në anën tjetër i kemi standardet e BE-së për mjedisin. Lidhur me ndërtimin e Termocentralit Kosova C shpjegoi se në një mbledhje të Bankës Botërore disa ekspertë kanë thanë se mund ta ndërtoni atë termocentral, por pas një periudhe dhjetëvjeçare duhet të ndalet. Mu për këtë pyeti se cili është mendimi i ministrit për ndërtimin e këtij termocentrali.

Hydajet Hyseni - Tha se ka ekzistuar një angazhim paradoksal dhe irritues i qeverive të mëparshme lidhur me Termocentralin Kosova C, duke bërë përpjekje ta arsyetonin ndërtimin e tij. Propozoi të merren masa parandaluese si për djegien, ashtu edhe për prerjen e pyjeve. Lidhur me zbatimin e ligjeve, tha: Edhe pse janë hartuar ligje shumë të mira, nuk ka veprime konkrete për zbatimin e tyre. Lidhur me Ligjin për zhurmën, tha se e keni cilësuar si një ndër sukseset tuaja miratimin e tij, mirëpo në praktikë nuk vërehet ndonjë ndryshim i madh. Kërkoj që në të ardhmen të paraqitet një raport për masat që ndërmerren për zbatimin e ligjeve.

Njomza Emini - E përkrahu punën e kësaj Ministrie dhe falënderoi për gatishmërinë e ministrit për ta paraqitur strategjinë.

Zylfije Hundozi – Pyeti se si është gjendja e teknologjisë së thëngjillit të pastër, nëse bëhet kontraktimi i ndërtimit të Termocentralit Kosova C, sepse thëngjilli ynë liron edhe dyoksid sulfuri. Po ashtu pyeti se në çfarë vështirësish hasni kur nxirren udhëzime administrative.

Mahir Jagcilar - Shpjegoi se mjedisi nuk mund të anashkalohet përkundër faktit që nuk është në prioritetet kryesore të Qeverisë. Lidhur me projektet për Konferencën e Donatorëve, tha se, nuk kemi projekte konkrete. Sa i përket zbatimit të ligjeve tha se duhet ta bëjmë një monitorim më të madh, për shkak se deri më tani nuk ka pasur ndonjë monitorim të ligjeve. Shtoi se nuk ekziston ndonjë ndalesë për automjetet që nuk kanë filtër të ajrit. Për ta pakësuar lirin e dyoksidit të karbonit nga Termocentrali Kosova A duhet të vendosen filtra që kushtojnë dhjetë milionë euro dhe duhet të ndërpritet rryma deri sa ata të vendosen. Sa i përket ndërtimit të Termocentralit C, tha se Kosova, ka nevojë për stabilitet energjetik e për këtë duhet të ndërmerren hapa konkretë. Shtoi: Nëse Termocentrali C do të ndërtohet sipas standardeve evropiane do të ketë ndotje varësisht

nga sasia e prodhimit dhe nuk do të ketë vend për frikë. Lidhur me mbrojtjen e pyjeve tha se do të ketë një memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Bujqësisë dhe të Planifikimit Hapësinor.

Nait Hasani – Pyeti: Edhe sa jetë njerëzish duhet të shkojnë deri sa të bëhet instalimi i filtrave që kushton dhjetë milionë euro. A keni ndonjë projekt konkret se çka do të bëni me dyoksidin e karbonit që lirohet mbi limitin e lejuar. Si do të veproni me hirin që do të krijohet, pasi ekziston një sasi shumë e madhe e hirit.

Mahir Jagcilar - Tha se për ndalimin e lirimit të dyoksidit të karbonit ose duhet të blihen dhe të instalohen filtrat, ose të ndërpritet rryma.

Hydajet Hyseni – Tha për ne është me rëndësi të dimë se vizioni i Qeverisë a është në përputhje me standardet evropiane dhe a është ndërtuar strategjia në atë mënyrë që kërkesat të jenë në relacion me BE-në. Shtoi se nuk kam mundur ta kuptoj asnjëherë futjen e zonave të mbrojtura, që janë kryesisht zona të mbrojtura kulturore dhe religjioze në fushën e Ministrisë suaj, sepse shtrohet çështja si do të mbrohen këto zona. Më pëlqen që është një ligj për sigurinë bërthamore, por s'ë di sa jemi të ballafaquar me problemin e armëve bërthamore. Lidhur me çështjen e vendbanimeve joformale kërkoj që edhe kjo ministri të punojë sa më shumë për zgjidhjen e këtij problemi.

Mahir Jagcilar - Jemi duke u përpjekur ta bëjmë strategjinë për përafrimin e legjislacionit dhe kemi kontakte me zyrtarët evropianë. Lidhur me Ligjin për zonat e mbrojtura, tha se Ligji ka dalë nga Pakoja e Ahtisarit dhe ne jemi caktuar përgjegjës.

4. Të ndryshme

a) Lidhur me organizimin e udhëtimeve zyrtare

Zylfije Hundozi - I njoftoi anëtarët e Komisionit se në takimin e mbajtur me kryetarin e Kuvendit është diskutuar për organizimin e vizitave zyrtare të komisioneve. Shtoi se kryetari i Kuvendit ka propozuar që të gjitha vizitat që realizohen të kontrollohen nga Komisioni për Punë të Jashtme, mirëpo me këtë propozim unë nuk jam pajtuar. Ajo shtoi se ka kërkuar që Komisioni të ketë buxhet të ndarë për realizimin e programit të Komisionit.

Sabri Hamiti - Tha se është rregullorja që e obligon Kryesinë që të lejojë kush, ku dhe kur do të udhëtojë. Theksoi se në vendet e tjera ekziston një komision që merret me koordinimin e vizitave në mënyrë që të mos ketë vështirësi të funksionojë Kuvendi. Tha se gjatë realizimit të vizitave duhet parë edhe interesi për realizimin e vizitave dhe për krijimin e reciprocitetit.

Nait Hasani - Tha se të gjitha komisionet duhet të jenë të barabarta, ndërsa neve na del se Komisioni për Punë të Jashtme është më i privilegjuari. Shtoi se të gjitha këto vizita që realizohen e kanë për qëllim përfaqësimin e shtetit dhe shkëmbimin e përvojave.

Besa Luzha - Përfaqësuese e fondacionit Fridrih-Erbert-Stiftung i njoftoi anëtarët e Komisionit për agjendën dhe detajet e udhëtimit për në Kroaci.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40 min.

Procesmbajtëse
Adelina Demolli

Kryetarja e Komisionit
Zylfije Hundozi